



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:121213
Datë: 29.05.2024
Numri i dokumentit: 05753481
KE.nr.1246/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen juridike të paditësit F.F., me vendbanim në Gjilan, fshati Përlepnice, përfaqësuar sipas autorizimit nga Afrim Salihu, avokat nga Prishtina, kundër të paditurit R.R., me vendbanim në Gjilan, rruga “Mulla Idrizi” nr.118, përfaqësuar sipas autorizimit nga Shabi Isufi, avokat nga Gjilani, me objekt kontesti kthim i borxhit dhe pagesa e faturave, jashtë seancës me datën 29.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Hapet konflikti i kompetencës në mes të Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm dhe Gjykatës Komerciale të Kosovës – Departamenti për Çështje Ekonomike, për të vendosur në këtë çështje juridike kontestimore.
- II. Për të vendosur lidhur më konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

A r s y e t i m

Paditësi F.F., me datë 11.05.2018, përmes të autorizuarit të tij ka parashtruar padi për kthimin e borxhit dhe pagesën e faturave, kundër të paditurit R.R., në Gjykatën Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm.

Gjykata Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin C.nr.459/2018, të datës 19.08.2021, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje dhe lëndën e ka dërguar për vendosje në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, me arsyetim së në kuptim të dispozitave nga

neni 12 paragrafi 3 të Ligjit 06/L-054 për Gjykatat, kompetente është Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, sipas kompetencës lëndore sepse Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike është kompetente për të gjykuar dhe ka juridiksion ekskluziv në kontestet ndërmjet subjekteve ekonomike të cilat ekskluzivisht merren me veprimtarinë e biznesit.

Gjykata duke u bazuar në nenin 13 par. 1.1 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, me të cilin përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.1. kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre”*, vlerëson se në rastin konkret është kompetente pikërisht Gjykata Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm, për faktin se në rastin konkret paditësi dhe i padituri janë persona fizike, ndërsa Departamenti për Çështje Ekonomike në kuadër të Dhomave të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale është kompetent për të vendosur kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridik publik dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre, rezulton se kjo çështje nuk bie në kompetencë lëndore të kësaj gjykate.

Andaj Gjykata Komerciale e Kosovës duke vepruar sipas dispozitës së nenit 24 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke hapur konfliktin e kompetencës në këtë çështje juridike kontestimore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.1246/23, datë 29.05.2024

Gjyqtarja

Verona Dibra

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, nuk është e lejuar ankesa.